fondiBESA

RAPORT VJETOR

2015

www.fondibesa.com

Përmbajtja

PROFILI I FONDIT BESA sh.a. 3
MESAZHI I DREJTORIT EKZEKUTIV 4
ZHVILLIMI INSTITUCIONAL 6
IMPAKTI YNË 7
FONDI BESA NË SHIFRA 8
ARRITJET 2015 9
MENAXHIMI I INSTITUCIONIT DHE OBJEKTIVAT AFATMESME 10
SHTRIRJA E AKTIVITETIT 11
BILANCI 12
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE 13
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË 14
BURIMET NJERËZORE 16
STRUKTURA ORGANIZATIVE 17
PËRGJEGJËSIA SOCIALE E AKTIVITETIT 18
RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR 20
HISTORI SUKSESI 21
PARTNERËT 23

Profili i Fondit BESA sh.a

Fondi BESA është institucion financiar jo-bankë, me një eksperiencë 22 vjeçare, i specializuar në financimin e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Ne synojmë të sigurojmë produkte dhe shërbime financiare, të cilat plotësojnë dhe tejkalojnë pritshmëritë e klientëve tanë. Ne kërkojmë të jemi zgjedhja e parë e klientëve në segmentin e biznesit të vogël dhe të mesëm në Shqipëri; institucioni financiar numër një dhe më i besueshmi për tregun në të cilin operojmë.

Misioni ynë është nxitja e rritjes ekonomike të vendit, duke promovuar zhvillimin e sektorit të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme, nëpërmjet mbështetjes së tyre me kredi.

Përmbushja e këtij misioni synon krijimin e vlerave për të gjithë partnerët tanë, qofshin këta klientët, bashkëpunëtorët apo financuesit, për një kontribut më të gjerë në shoqëri:

- Rritje të punësimit nëpërmjet mbështetjes së biznesit të vogël dhe të mesëm që konsiderohen motori i zhvillimit ekonomik;
- Mbështetje për të rinjtë dhe shtresat e margjinalizuar për krijimin dhe zhvillimin e biznesit të tyre dhe krijimin e mundësive të vetëpunësimit;
- Shërbim të shkëlqyer për klientët tanë aktualë dhe ata potencialë që operojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë;

Me një staf prej 411 punonjësish dhe një rrjet të gjerë prej 68 zyrash të shpërndarë në të gjithë vendin, Fondi BESA është një nga institucionet mikrofinanciarë më të mëdhenj në Shqipëri që synon të jetë sa më afër tregut të tij, për të plotësuar nevojat e klientëve në kohë reale.

Mesazhi i Drejtorit Ekzekutiv

Qëllimi

...të jemi zgjedhja e parë për tregun e synuar...

Strategjia

...nëpërmjet një aktiviteti të suksesshëm të gjenerojmë vlerë për klientët, partnerët dhe punonjësit tanë...

2015 ishte një vit i vështirë, por i suksesshëm për Fondin BESA. Gjatë këtij viti, ne arritëm të realizojmë dhe të tejkalojmë objektivat e planifikuara, duke arritur rezultate që kanë një rëndësi të veçantë për vazhdimësinë e qëndrueshme të aktivitetit në të ardhmen.

Ajo çka vumë re ishte se kërkesa për kredi gjatë vitit 2015 pësoi një rritje të kënaqshme në raport me vitin 2014. Një ndër sfidat tona ishte plotësimi i nevojave për kredi të tregut tonë, duke mbetur një institucion i orientuar ndaj kërkesave të klientëve – lider në tregun e mikrofinancës në Shqipëri.

Në vitin 2015, Fondi BESA disbursoi 19,549 kredi, ose 7.93% më shumë se në vitin 2014, me vlerë totale prej 5.5 Miliardë Lekë, ose 8,35% më shumë se në vitin 2014. Konsolidimi dhe zgjerimi i aktivitetit të Fondit BESA mbetet një sfidë permanente. Ne e zgjeruam aktivitetin edhe në zona të reja, duke u bërë gjithnjë e më shumë prezent në zonat urbane dhe gjysmë urbane.

Në fund të vitit 2015, Fondi BESA kishte 411 punonjës, me një aktivitet prej 30,028 klientësh dhe portofol prej 6.3 Miliardë Lekë, duke qenë prezent me 68 zyra në të gjithë territorin e vendit.

Kapitali shënoi rritje prej 18.63%, në raport me vitin 2014, duke arritur vlerën e 1,835,441,411 lekëve.

Rezultatet pozitive të Fondit BESA në vazhdimësi janë vlerësuar nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fondi BESA, edhe në të ardhmen do luajë një rol të rëndësishëm në mbështetjen financiare të sipërmarrjes së vogël dhe të mesme në Shqipëri, në rritjen e punësimit, duke qenë një faktor i qenësishëm në zbutjen e varfërisë dhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Gjatë vitit 2016 dhe më tej, strategjia e Fondit BESA do synojë fokusimin në prioritetet e mëposhtme: rritja e aktivitetit duke i kushtuar vëmendje të shtuar përmirësimit të eficencës dhe produktivitetit të stafit; rritja e gamës së produkteve ofruar klientelës; shërbim i shkëlqyer ndaj klientelës; përmirësim i mëtejshëm i rezultateve financiare.

Vizioni ynë është të mbetemi një institucion i besueshëm dhe i suksesshëm. Ne kërkojmë të jemi një

Fokusi

...mbështetje financiare me produkte dhe shërbim cilësor për klientët tanë...

institucion me sukses afatgjatë për punonjësit, klientët dhe aksionarët. Ne, do të vazhdojmë të mbetemi një institucion ku punonjësit zgjedhin të punojnë tek ne sepse besojnë në institucion dhe në rolin e tij të vlefshëm në shoqëri. Në vazhdimësi, në themel të punës dhe përpjekjeve për realizimin e objektivave dhe përmbushjes së misionit, Fondi BESA do të ruajë parimet e transparencës, integritetit dhe korrektësisë.

Si Drejtor i Fondit BESA, dua t'i shpreh mirënjohjen përpjekjeve, angazhimit dhe performancës së gjithë punonjësve që kanë bërë të mundur suksesin gjatë 2015 dhe urojmë një angazhim të vazhdueshëm të tyre për vitet e ardhshme, vite që do të jenë po aq intensivë dhe me aktivitete që do të japin impakte gjithnjë e më shumë pozitive në jetën social-ekonomike të vendit.

Së bashku, ne do të bëjmë një institucion më të fortë e të suksesshëm – një institucion, i cili do të krijojë vlerë për klientët, stafin, aksionarët dhe për të gjithë shoqërinë.

Miqësisht,

Prof. Asoc. Dr. Bajram MUÇAJ

Drejtor Ekzekutiv

Zhvillimi institucional

Në vijim

Vazhdimi i zgjerimit dhe konsolidimit të aktivitetit.

2009

Fillimi i aktivitetit të Fondit BESA sh.a, i cili trashëgoi portofolin dhe asetet e Fondacionit BESA.

2008

Krijimi i Fondit BESA si shoqëri aksionare. Licencimi nga Banka e Shqipërisë si një Institucion Financiar Jo-Bankë

1999

Krijimi i Fondacionit BESA si një organizatë joqeveritare, jopolitike dhe jofitimprurëse.

1994

Nis aktiviteti si Projekt i Mikrokredisë Urbane, në kuadër të një projekti të Bankës Botërore dhe Qeverisë Shqiptare.

Impakti ynë

MË SHUMË VENDE PUNE TË KRIJUARA

Fondi BESA është renditur si një ndër 100 kompanitë më të mëdha në Shqipëri, sipas numrit të punësuarve. Në të njëjtën kohë, bizneset e financuara nga Fondi BESA krijojnë mundësi për krijim të vendeve të punës, në një mjedis ku niveli i papunësisë gjatë vitit 2015 ishte 17.3%

MË SHUMË BIZNESE TË FINANCUARA

Gjatë 2015 disbursuam 19,549 kredi nga të cilat rreth 55% ishin kredi për klientë të rinj.

MË SHUMË MBËSHTETEJE PËR GRATË NË BIZNES

Me synimin për një përfshirje sa më të gjerë të grave në biznes për fuqizimin e tyre financiar dhe social, kemi financuar 6,290 biznese (ose 32.2%) të cilat drejtohen nga gratë.

MË SHUMË ZYRA PËR TË QENË MË AFËR KLIENTELËS

Hapëm 2 Degë të reja Rajonale dhe 3 Zyra Satelite për të qenë prezent aty ku është nevoja dhe kërkesa për financim.

PROCEDURA TË SHPEJTA DHE TRANSPARENTE

Kohëzgjatja për dhënien e një kredie dhe transparenca e gjithë procesit kanë rëndësi për ne. Fondi BESA aplikon një sistem online, çka bën të mundur marrjen e vendimit dhe procesin e disbursimit brenda një kohe të shkurtër dhe pa vonesa.

Asete totale

8.7 miliardë lekë

Kapital

1.8 miliardë lekë

Kthimi mbi Asetet

3.42%

Kthimi nga Kapitali

17.04%

Klientë Aktivë

30,028

FONDI BESA NË SHIFRA

Portofoli i Kredisë

6.3 miliardë lekë

Kredi të dhëna gjatë vitit

19.549

Shuma Kumulative

48.9 miliardë lekë

Shuma e disbursuar në vit

5.5 miliardë lekë

Kredi Kumulative

147,302



	2011	2012	2013	2014	2015
Nr.i Kredive Aktive	19,231	22,894	25,970	28,462	30,028
Teprica e kredisë ('000,000 lekë)	4,459	5,000	5,408	5,8378	6,282



	2011	2012	2013	2014	2015
Nr. Kredive të Disbursuara	11,420	14,619	16,549	18,113	19,549
Shuma e Disbursuar në Vit ('000,000 lekë)	3,370	4,366	4,736	5,063	5,486



Arritjet 2015

	20111	2012	2013	2014	2015
Nr. Kumulativ i Kredive	78,472	93,091	109,640	127,753	147,302
Shuma Kumulative e Disbursuar ('000,000 lekë)	29,258	33,626	38,363	43,426	48,895

Kursi i këmbimit 31.12.2015 US$/Lek: 125.79
EUR/Lek: 137.28

Kursi i këmbimit 31.12.2014 US$/Lek: 115.23
EUR/Lek:140.14

Menaxhimi i Institucionit dhe Objektivat Afatmesme

Menaxhimi efektiv i Fondit BESA është kyçi për funksionimin dhe arritjen e objektivave. Parimet mbi të cilat e ndërton punën menaxhimi janë të qarta dhe, nëpërmjet hartimit të politikave dhe strategjive të duhura, synojnë rritjen e efektivitetit të aktivitetit, menaxhimin sa më të mirë të fondeve dhe menaxhimin e risqeve me të cilat përballet institucioni.

Menaxhimi fokusohet në strategjitë që beson se do të ndikojnë në shëndetin afatgjatë të institucionit.

Objektivi kryesor afatmesëm mbetet zgjerimi i aktivitetit kredidhënës, duke disbursuar rreth 22.5 miliardë lekë gjatë tre viteve të ardhshme dhe duke rritur portofolit e kredisë në nivelin rreth 8.5 miliardë lekë në fund të vitit 2018.

Objektivat do të arrihen nëpërmjet:

- Rritjes dhe përmirësimit të eficencës dhe produktivitetit.
- Konsolidimit dhe zgjerimit të aktivitetit në zyra të reja, për t'i ofruar akses më të madh klientelës kundrejt shërbimeve tona.
- Ruajtjes në vazhdimësi të një cilësie të lartë të portofolit në risk.
- Hartimit të produkteve të reja në përputhje me nevojat dhe preferencat e klientelës dhe strategjinë institucionale.
- Ruajtjes dhe përmirësimit të treguesve dhe vetë-qëndrueshmërisë financiare të institucionit.
- Rritjes së kapacitetit dhe motivimit të stafit për t'ju përgjigjur ritmeve të rritjes së institucionit.

Shtrirja e Aktivitetit

Fondi BESA e ushtron veprimtarinë e tij në 68 zyra, të organizuara në 24 Degë Rajonale; 43 Zyra Satelite; 1 Arkë. Prezenca e institucionit në të gjithë Shqipërinë bën të mundur një njohje dhe kuptim më të mirë të nevojave të tregut ku operon, hartimin e produkteve që i përgjigjen këtyre nevojave dhe plotësimin e tyre në kohë.



	Nr. Aktive	Outstanding
Shkodra 1	940	190,901,985
Shkodra 2	858	170,709,615
Kukës	1,181	202,916,326
Lezhë	1,097	252,521,440
Peshkopi	726	138,508,196
Fushë-Krujë	1,306	264,027,448
Durrës 1	1,631	271,335,171
Durrës 2	1,422	276,376,905
Tirana 1	1,503	422,376,405
Tirana 2	1,329	300,111,488
Tirana 3	1,632	312,997,129
Tirana 4	1,421	524,333,018
Tirana 5	1,172	319,528,874
Tirana 6	1,075	324,090,274
Elbasan 1	1,546	240,063,479
Elbasan 2	1,289	171,446,421
Pogradec	1,439	231,770,563
Korçë	1,729	211,169,666
Berat	1,493	262,882,800
Lushnje	1,071	157,080,773
Fier	1,453	252,314,796
Vlorë	1,211	216,471,719
Gjirokastër	836	153,016,070
Sarandë	624	170,808,384

Bilanci

Shifrat në lekë	**2015**	**2014**
AKTIVE		
Mjete monetare dhe ekuivalente	385,544,401	950,356,095
Depozita me afat me bankat	1,809,242,832	1,204,693,754
Hua dhënë klientëve	6,049,367,064	5,616,716,400
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	80,689,165	79,396,687
Aktive afatgjata të vlefshme për investim	251,916,430	220,108,010
Aksionet në shoqëritë e lidhura	54,000,000	15,000,000
Aktive të tjera	70,027,529	52,448,138
Totali i Aktiveve	**8,700,787,421**	**8,138,719,084**
DETYRIMET DHE KAPITALI		
Detyrimet		
Hua dhe Kredi	4,733,376,950	4,501,257,178
Borxh i varur	1,938,443,878	1,941,300,742
Grante	44,892,072	19,910,770
Tatim fitimi i pagueshëm	17,658,011	8,772,201
Detyrime të tjera	130,975,099	120,271,895
Totali i Detyrimeve	**6,865,346,010**	**6,591,512,786**
Kapitali		
Kapitali Aksionar	1,494,838,000	1,300,773,000
Rezerva ligjore	52,368,299	42,153,908
Fitime të mbartura	288,235,112	204,279,390
Totali i Kapitalit	**1,835,441,411**	**1,547,206,298**
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit	**8,700,787,421**	**8,138,719,084**

Kursi i Këmbimit 31.12.2015 US$/Lek: 125.79 EUR/Lek: 137.28

Kursi i Këmbimit 31.12.2014 US$/Lek: 115.23 EUR/Lek: 140.14

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Shifrat në lekë	**2015**	**2014**
Interesa		
Të ardhura nga Interesat	1,590,470,666	1,457,394,059
Shpenzime për interesat	(336,092,200)	(313,783,924)
Të ardhura neto nga Interesat	**1,254,378,466**	**1,143,610,135**
Të ardhura të tjera		
Të ardhura nga Grantet	3,110,944	735,140
Të ardhura të tjera, neto	95,409,491	92,393,350
Totali të ardhurave të tjera	**98,520,435**	**93,128,490**
Shpenzime Operative		
Humbja nga zhvlerësimi i kredive për klientët	(156,370,604)	(158,297,902)
Shpenzime personeli	(572,619,227)	(536,063,858)
Shpenzime të tjera administrative	(257,197,800)	(252,996,347)
Amortizimi	(25,148,139)	(42,988,861)
Humbjet neto nga lëvizjet në kursin e këmbimit	(524,670)	(2,308,493)
Totali i Shpenzimeve Operative	**(1,011,860,440)**	**(992,655,461)**
Fitimi para tatimit	**341,038,461**	**244,083,164**
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin	**(52,803,349)**	**(39,803,774)**
Fitimi neto i periudhës	**288,235,112**	**204,279,390**
Të ardhura të tjera përmbledhëse neto nga tatimi mbi fitimin	-	-
Totali të ardhurave përmbledhëse	**288,235,112**	**204,279,390**

Kursi i Këmbimit 31.12.2015 US$/Lek: 125.79 EUR/Lek: 137.28

Kursi i Këmbimit 31.12.2014 US$/Lek: 115.23 EUR/Lek: 140.14

Pasqyra e flukseve të parasë

Shifrat në lekë	**2015**	**2014**
Flukset e arkës nga aktivitete operative		
Fitimi neto i periudhës	288,235,112	204,279,390
Korrigjime për rakordimin e ndryshimeve të aktiveve neto me mjetet monetare neto nga aktivitetet operative:	-	-
Zhvlerësimi	18,503,957	35,955,557
Amortizim	6,644,182	7,033,304
Nxjerrje jashte perdorimit e aktiveve	186,584	914,879
Humbje/(Fitime) nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve	555,544	(754,303)
Humbjet nga zhvlerësimi i huave për klientët	156,370,604	158,297,902
Amortizimi I Granteve	(3,110,944)	(735,140)
Diferenca të kursit të këmbimit nga rivlerësimi i granteve	(327,438)	662,465
Hua të fshira	6,918,786	8,861,195
Amortizimi i komisioneve të disbursimit të huave	(127,488,849)	(114,102,901)
Të ardhura nga interesat	(1,590,470,666)	(1,457,394,059)
Shpenzime për interesa	336,092,200	313,783,924
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin	52,803,349	39,803,774
Ndryshime në :	-	-
Hua për klientët	(571,291,012)	(632,410,392)
Aktive të tjera	(17,579,391)	(20,631,387)
Detyrime të tjera	10,703,204	5,168,454
Komisione të arkëtuara të disbursimit të huave	127,488,849	114,102,901
	(1,305,765,929)	(1,337,164,437)
Interesi i arkëtuar	1,593,327,530	1,406,913,063
Interesi i paguar	(391,618,365)	(280,986,294)
Tatimi mbi fitimin i paguar	(43,917,538)	(37,967,413)
Flukse e arkës nga aktivitetet operative, neto	**1,157,791,627**	**1,087,959,356**

Kursi i Këmbimit 31.12.2015 US$/Lek: 125.79 EUR/Lek: 137.28

Kursi i Këmbimit 31.12.2014 US$/Lek: 115.23 EUR/Lek: 140.14

Pasqyra e flukseve të parasë

Shifrat në lekë	**2015**	**2014**
Flukset e arkës nga aktivitete investuese		
Blerje e aktiveve afatgjata	(19,983,019)	(17,465,502)
Blerje e aktiveve afatgjata të vlefshme për investim	(46,330,417)	(58,263,531)
Rritje në depozitat me afat në banka	(590,741,079)	(17,165,899)
Investime në shoqëritë e lidhura	(39,000,000)	(15,000,000)
Të ardhurat nga shitja e aktiveve fikse	7,322,271	21,426,915
Flukset e arkës përdorur në aktivitetet investuese	**(688,732,244)**	**(86,468,017)**
Flukset e arkës nga aktivitete financuese		
Të ardhura nga huatë dhe detyrimet e varura	243,475,169	1,083,537,758
Të ardhura nga grantet	28,419,684	14,352,590
Flukset e arkës gjeneruar aktivitetet financuese	**271,894,853**	**1,097,890,348**
(Ulje)/rritje neto në mjete monetare dhe ekuivalente	(564,811,694)	762,217,250
Mjete monetare dhe ekuivalente në fillim të vitit	950,356,095	188,138,845
Mjete monetare dhe ekuivalente në fund të vitit	**385,544,401**	**950,356,095**

Kursi i Këmbimit 31.12.2015 US$/Lek: 125.79 EUR/Lek: 137.28

Kursi i Këmbimit 31.12.2014 US$/Lek: 115.23 EUR/Lek: 140.14

Burimet njerëzore

…krijimi i një mjedisi që mbështet produktivitetin e punonjësve, ku ata mund të përmbushin potencialet e tyre...

Ne besojmë se vetëm duke ndërtuar ekipe punonjësish profesionistë, të talentuar, me ekspertizë në fusha të ndryshme, aftësi dhe eksperiencë, do të mund të krijojmë ato vlera që na duhen për institucionin.

Politikat e burimeve njerëzore synojnë zhvillimin dhe rritjen e mëtejshme të kapacitetit të punonjësve, promovimin në pozicione drejtuese të punonjësve me performancë më të lartë, krijimin e një ambienti pune ku janë të mirëpritura vlerat më të mira, shpirti i iniciativës dhe mënyra të ndryshme të menduari për sfidat që na presin.



Gjatë vitit 2015 kemi bërë progres në lidhje me rritjen e numrit të femrave si në poste drejtuese ashtu edhe në administratë dhe në nivel oficerë kredie. Aktualisht 32% e drejtuesve të degëve rajonale dhe 41 % e oficerëve të kredisë janë femra.

Përsosja e strukturës organizative të Fondit BESA ka qëllim rritjen e efikasitetit të aktivitetit, duke bërë të mundur në të njëjtën kohë një koordinim, bashkëpunim dhe komunikim më të mirë midis sektorëve dhe departamenteve të ndryshëm.

Një fokus të veçantë i kemi kushtuar motivimit të punonjësve nëpërmjet shpërblimit dhe krijimit të skemave nxitëse. Ne besojmë se shpërblimi është më shumë se një pagesë. Ne kemi krijuar skema të tilla ku çdo punonjës shpërblehet sipas nivelit të përgjegjësisë dhe arritjeve. Vendosja e objektivave personale dhe e niveleve të kompetencave janë pjesë e kësaj skeme.

Menaxhimi i institucionit i kushton vëmendje të veçantë mënyrës si t'i mbajë punonjësit të angazhuar dhe të motivuar. Përveç ofrimit të një mjedisi pune ku secili ka mundësinë të shprehë aftësitë dhe ambiciet, në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit, Fondi BESA u ofron punonjësve shanse për të zhvilluar karrierën, si nëpërmjet trajnimeve të specializuara, ashtu edhe nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave lokale apo ndërkombëtare.

Të gjitha këto politika synojnë në zhvillimin dhe rritjen e performancës së stafit për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të Fondit BESA.

Struktura Organizative



Përgjegjësia sociale

Fondi BESA, tashmë me një aktivitet prej 22 vitesh, ka dhënë kontributin e tij në uljen e nivelit të varfërisë, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e biznesit të vogël dhe të mesëm, çka kanë dhënë impaktin e tyre në rritjen e mirëqenies së klientëve.

Në qendër të përgjegjësisë sociale janë njerëzit, qofshin këta punonjës të institucionit apo klientët dhe bashkëpunëtorët tanë. Ndaj edhe një nga sfidat tona kryesore mbetet mbështetja e punonjësve tanë që në momentin që ata punësohen dhe gjatë gjithë karrierës së tyre në Fondin BESA.

Nxitja e një frymë të hapur dialogu dhe komunikimi, dëgjimi i mendimeve dhe sugjerimeve të stafit dhe hartimi i politikave të duhura për një ambient pune ku secili të ndjehet i motivuar dhe të japë më të mirën në performancën e tij, mbetet në qendër të politikave të burimeve njerëzore.

Duke qenë një institucion që operon në një mjedis të caktuar, Fondi BESA ka ndjeshmëri të veçantë për mjedisin që e rrethon. Për këtë kemi hartuar politika, të cilat përjashtojnë financimin e aktiviteteve që dëmtojnë mjedisin si dhe politika të brendshme në lidhje me konsumin e energjisë, ujit dhe të letrës. Në të njëjtën mënyrë, ne i inkurajojmë klientët tanë të kenë në vëmendje aspektin mjedisor kur zhvillojnë bizneset e tyre dhe të marrin masa për të ulur sa më shumë të jetë e mundur ndikimin negativ të biznesit në mjedis.

Veç produkteve dhe shërbimeve financiare, Fondi BESA vazhdon të angazhohet në projekte, të cilat reflektojnë përgjegjësinë sociale si pjesë e kulturës së institucionit.

Projekti “Skemë e Re Mikrokredie për Fuqizimin e Grave”

Fondi BESA, në bashkëpunim me L.V.I.A. Albania dhe Mag2Finance, gjatë vitit 2015 implementuan me sukses projektin “Skemë e Re Mikrokredie për Fuqizimin e Grave”, pjesë e projektit KEP Austria. Ky projekt u bashkë-financua nga Kooperacioni Austriak për Zhvillim. Në kuadër të këtij projekti u financuan me kushte lehtësuese biznese në pronësi apo administrim të grave në rrethin e Shkodrës. Ky projekt u finalizua me sukses, duke pasur një impakt mjaft pozitiv në fuqizimin financiar të grave dhe në përfshirjen e tyre sociale në jetën e vendit.

“BESA AGRO” Projekt

Gjatë vitit 2015, Fondi BESA u angazhua në zbatimin e projektit “Bukë, Kripë e Zemër – Ushqimi, Tradita dhe Kultura: Procese të Bashkë-Zhvillimit të Zonave të Margjinalizuara të Veriut dhe Jugut të Shqipërisë” në bashkëpunim me VIS Albania dhe CESVI, projekt i financuar nga Kooperacioni Italian. Në kuadër të këtij projekti, për të dytin vit radhazi janë financuar me kushte favorizuese aktivitetet bujqësore e blegtorale në qarkun e Shkodrës dhe rrethin e Përmetit. Ky projekt synon rritjen social-ekonomike me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së popullsisë në zonat rurale të rrethit Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë dhe Përmet.

Gjatë vitit 2015, Fondi BESA sh.a. dhuron 10 laptopë për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile.

Për të mbështetur mbarëvajtjen dhe efikasitetin e punës, Fondi BESA i dhuron Bashkisë së Tiranës disa kompjuterë dhe monitorë.

Ashtu si dhe vitet e kaluara, Fondi BESA ofron mundësi intershipi për studentë të universiteteve, kryesisht të degës financë, duke u ofruar atyre mundësi të zbatojnë në praktikë njohuritë e marra, të kuptojnë si funksionon një institucion mikrofinanciar dhe ta mendojnë atë si një mundësi punësimi në të ardhmen. Brenda kësaj filozofie ne i dhamë mundësi punësimi një grupi prej 13 të rinjve të sapodiplomuar, një pjesë e të cilëve, pas një periudhe trajnimi dhe testimi arritën të punësohen në pozicione të ndryshme në institucion.

Raporti i auditoreve të pavarur



KPMG

KPMG Albania Shpk
"Dëshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Telephone +355(4)2274 524
+355(4)2274 534
Telefax +355(4)2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i auditueve të pavarur

Pronarëve të
Fondi Besa Sh.a.

Tiranë, 18 April 2016

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Fondi Besa Sh.a. ("Shoqëria"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar në 31 dhjetor 2015, pasqyrat e fitimi humbjeve dhe të ardhurave përmbledhëse te tjera, ndryshimeve në kapital dhe fluksëve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Auditueve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditueesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, ne marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojmë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Opinioni

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2015, rezultatin e saj financiar dhe rrjedhjen e parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Fatos Beqja
Auditues ligjor

KPMG Albania Shpk.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

Histori suksesi

MYRVETE RADA

Argjendari

Përpara viteve 1990, Myrvete dhe bashkëshorti i saj punonin në ndërmarrjen artistike Migjeni, e njohur për prodhimin e produkteve artistike. Pasi ndërmarrja u mbyll, ata preferuan të punësohen, ndërsa ideja e hapjes së një biznesi privat i dukej i pamundur, megjithëse e njihnin mirë profesionin e argjendarit.

"...Por pasioni për artin e të punuarit të arit dhe argjendit fitoi. Vendosëm të kishim punishten tonë të vogël – thotë Myrvetja. Nuk ishte e lehtë të merrnim një vendim të tillë. Na duhej ta diskutonim në detaje, të bënim një kërkim për të kuptuar çfarë kërkonte tregu, cilët materiale preferoheshin më shumë, çfarë preferonin grupmoshat e ndryshme, cilat ishin çmimet e tregut, etj.

E nisëm duke investuar kursimet tona dhe fillimisht ishim të kënaqur. Bashkëshorti im punonte arin dhe argjendin, ndërsa unë merresha me marketingun dhe shitjet. Shpejt filluam të kishim klientelën tonë dhe kërkesat po rriteshin. Ishte koha për të blerë një pajisje të re, por nuk mundeshim me të ardhurat tona. Në këtë kohë kontaktuam me Fondin Besa, por vendimi për të marrë një kredi nuk ishte fare i lehtë."

Ata morën kredinë e parë në shumën 700,000 lekë dhe, falë punës dhe menaxhimit të shkëlqyer të biznesit, ja dolën jo vetëm të paguajnë kredinë, por edhe të investonin më tej në biznes.

Ishte përsëri Fondi Besa të cilit ju drejtuan për të marrë kredinë e dytë dhe të tretë për blerjen e materialeve dhe për të përmirësuar ambientin e dyqanit ku shesin produktet e tyre.

Nazmiu, bashkëshorti i Myrvetes thotë: *"Jam shumë i kënaqur me biznesin tonë. Tashmë kemi klientë jo vetëm nga Tirana, por edhe të huaj të cilët parapëlqejnë të kenë një suvenir nga Shqipëria"*

Histori suksesi

MAJLINDA GURRA

Qëndistari

Megjithëse të punosh në emigracion nuk është e lehtë, për Majlindën ishte një eksperiencë e mirë. Gjithnjë ka pasur interes për qëndistarinë, por nuk e kishte menduar se kjo do të kthehej në karrierën e saj. Pas disa vitesh eksperiencë pune në qëndistari jashtë Shqipërisë, së bashku me familjen vendosën të kthehen në Tiranë dhe të hapin një dyqan.

"...kemi kaluar orë pafund duke provuar materiale të ndryshme dhe duke realizuar punime me modele të shumëllojshme për të qenë unik në treg - thotë Majlinda."

Ajo që kërkonte ishte të identifikohej në një treg që ishte relativisht konkurrues, dhe konkurrencës mund t'i bënte ballë vetëm me cilësi. Ajo kërkonte më të mirën për vete dhe klientelën. U përpoq dhe arriti të marrë ekskluzivitetin e kompanisë franceze DMB – një kompani me një histori 268 vjeçare dhe me zyra në të gjithë botën, e cila është e njohur për cilësi të lartë të materialeve që përdor, sidomos për fillin e mëndafshit që është numri një i përdorur në botë.

"…në atë kohë nuk ishte e mundur të përballonim çmimin e blerjes së materialeve nga DMC dhe na u desh të merrnim kredi. Me kredinë e parë nga Fondi Besa blemë materiale të ndryshme. Dhe vërtetë, diferencën e bëri cilësia e copave, fijeve dhe ngjyrat, ndërsa sa për veglat që përdorim, vazhdon të mbetet gjilpëra, pra një punë krejtësisht artizanale. Një kredi e dytë na ka ndihmuar të blejmë materialet në kohën e duhur për të plotësuar kërkesat në rritje të klientelës. Sot, tek ne gjeni materiale nga më të shumëllojshme si dhe qëndisje të modeleve nga më të bukurat. Kemi punësuar 4 gra dhe njëkohësisht furnizojmë me materiale edhe 5 dyqane.

Që prej 12 vjetësh tashmë kam dyqanin tim. Qëndistaria është art dhe si gjithë artet kërkon shumë punë dhe pasion, por s'ka më bukur kur dikush vesh apo shtron diçka nga duart e tua dhe kënaqet."

Partnerët

Banka Botërore

Banka Europiane
për Zhvillim dhe Ndërtim

Banka e Detit të Zi
për Tregti dhe Zhvillim

Qeveria Shqiptare

IFC International Finance Corporation
World Bank Group

Agjencia Spanjolle e Bashkëpunimit ndërkombëtar

Fondacioni Shoqëria e Hapur
për Shqipërinë

BIB FAIR BANKING

CoopEst
finance for social economy | initiatives in central eastern europe

Frankfurt School of Finance & Management
German Excellence. Global Relevance.

ALBANIAN BESA CAPITAL
Fondacioni ABC

Raiffeisen BANK

BKT
BANKA KOMBETARE TREGTARE

SOCIETE GENERALE ALBANIA

TIRANA BANK

Fondi BESA sh.a.
Rruga: "Brigada VIII", Pallati Nr. 5
(zona e ish-Bllokut), Tiranë - Shqipëri
Tel: 04 2253841/2 Fax: 04 2253836
E-mail: mfi@besa.org.al www.fondibesa.com